

Sektor i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 04.11.2019, miratoi siç vijon:

M E N D I M J U R I D I K

Nocioni kontest ekonomik në kuptim të dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore është kontest që rrjedh nga marrëdhëniet e ndërsjella ekonomike ndërmjet personave juridikë, organeve shtetërore, poseduesve të dyqaneve dhe të individëve të tjerë, të cilët si lloj profesioni të rregjistruar bëjnë ndonjë veprimtari ekonomike.

A r s y e t i m

Nocioni kontest ekonomik me Ligjin për procedurë kontestimore nuk është përcaktuar në kuptimin juridiko – material, ashtu që do të definohet se nga cilat marrëdhënie juridike rrjedhin kontestet ekonomike. Në vend të saj, me Ligjin për procedurë kontestimore nocioni kontest ekonomik përcaktohet në kuptim të procesit juridik me shfrytëzimin e disa kriterëve: kriterit kauzal (ratione causae), dhe kombinimin e kriterit kauzal dhe personal (ratione persone et causae).”

Në nenin 31 të Ligjit për Gjykatat nga viti 2006 është paraparë se gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, përveç kompetencës së përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji për territoret për të cilat janë themeluar, janë kompetente të vendosin në konteste tregtare, në të cilat të dy palët janë persona juridikë ose organe shtetërore, si dhe konteste së të drejtave të ngjashme dhe të drejtave të pronësisë industriale. Në këtë dispozitë, sipas mendimit të Sektorit të veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë përcaktimit të llojit të kontestit, nga aspekti i kompetencës së gjykatës, qëllimi i kuptimit qëndron në llojin e kontestit (tregtar...) dhe në cilësinë e palëve (persona juridikë ose organeve shtetërore).

Nocioni kontest ekonomik do të konstatohet edhe nëpërmjet interpretimit të nenit 4 të Ligjit për shoqëri tregtare, ku janë theksuar veprimtaritë që konsiderohen si tregtare, si dhe të nenit 17 të Ligjit për marrëdhënie obligative, në të cilin janë definuar marrëdhëniet tregtare.

**GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**